

VENDIM
Nr. 281, datë 17.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit nr. 752, datë 19.12 2018, të Këshillit Ministrave, “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të BA-së është i barabartë me shumën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë për çdo mbledhje, por, në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.”.

2. Pika 3, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shpërblimi i sekretarit teknik është i barabartë me shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje, por, në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

III. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi